



Pranimar / Dorezuar Prilbjenost/Prilobato Received/Delivered	26	11	2020	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOMSHCK	2778/2020		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.297/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Ardita Haxhinikaj Demi dhe Malsore Gashi-anëtarë, si dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.297/2020 të datës 13.10.2020 të parashtruar nga ankuesja ██████████, te cilën ankesë e ka parashtruar përmes e-mailit ankesa.kpmshck@rks-gov.net, kundër Vendimit me Nr. 141/2020 të datës 01.09.2020 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “transferim i përkohshëm”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr. 141/2020, i datës 01.09.2020 i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

II. DETYROHET Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të bëjë *rishqyrtimin* e rastit të ankueses duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

III. OBLIGOHET Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

V. Vendimi hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesja ██████████ e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme, sipas Akt emërimit Nr.017/2015 të ndryshuar dhe plotësuar me datë 13.03.2015 në pozitën “Udhëheqëse e Departamentit për Diplomaci Ekonomike me datë 08.03.2016, me vendimin, me numër Nr.Ref.078/2016, të U.D. Ministrisë së Punëve të Jashtme, , i është dhënë grada diplomatike “Këshilltare”, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bruksel/Mbretërinë e Belgjikës.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 10.07.2020 ka nxjerr vendimin, me numër protokollit Nr.322/2020, me të cilin ankuesen ██████████ me gradën diplomatike “Këshilltare”, e cila ka shërbyer në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bruksel/Mbretërinë e Belgjikës, pas përfundimit të mandatit, e kthen nga Misioni në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 01.09.2020, me numër protokoll 141/2020, ka nxjerr vendim me të cilin ankuesen e ka sistemuar përkohshëm në pozitën “Zyrtare e Lartë për Promovim dhe Investime” ne Departamentin për Diplomaci Ekonomike.

Ankuesja përmes emailit zyrtar te datës 22.09.2020, i drejtohet me kërkesë Zv. Sekretarit te Përgjithshëm duke kërkuar që të “rishikohet pozita në të cilën më keni sistemuar pas kthimit tim nga shërbimi në Ambasadën e Kosovës ne Londër”. Ankuesja lidhur me emailin zyrtar te datës 22.09.2020, nuk ka marr përgjigje.

Ankuesja [REDAKTUAR], e pakënaqur me vendimin e datës 01.09.2020, me numër protokoll 141/2020 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për sistemim të përkohshëm, për mes e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, me datën 13.10.2020 me numër protokoll 2065/2020, me ankesë i është drejtuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 23.10.2020, me numër protokoll 2229/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datën 30.10.2020 me numër protokoll 2372/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritot ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:2065/2020 të datës 13.10.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emali zyrtar i datës 15.09.2020, Vendimi i datës 01.09.2020, Nr. Ref.141/2020; Emali zyrtar i datës 22.09.2020; Kërkesa për përgjigje e datës 23.10.2020; Përgjigja ne kërkesë e datës 30.10.2020; Kontrata e marrëdhënies se punës e ankueses e datës 08.08.2008, nr.021/2008; Akt emërimi i ankueses nr.017, i datës 09.01.2013; Vendimi nr:MPJ-ZSP/198/2014 i datës 15.12.2014; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit nr.017/2015 i datës 13.03.2015; Vendimi Nr.Ref.078/2016 i datës 08.03.2016 për plotësim ndryshim te vendimit si dhe Vendimi Nr.322/2020 i datës 10.07.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar lëndën e ankueses dhe ka konstatuar se ekziston baza ligjore që ankesa e ankueses të kthehet në *rishqyrtim* duke e obliguar zv.Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që rastin e ankueses Znj. [REDAKTUAR] ta trajtoj në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me Vendimin me Nr.Ref 141/2020 të datës 01.09.2020 për sistemimin e përkohshëm të ankueses [REDAKTUAR], pas përfundimit te mandatit te saj ne Ambasadën e Republikës se Kosovës në Londër/Britani e Madhe, ankuesen e ka sistemuar në pozitën “Zyrtare e Lartë për Promovim dhe Investime” në Departamenti për Diplomaci Ekonomike. Zv. Sekretari i Përgjithshëm Vendimin me Nr.Ref 141/2020 të datës 01.09.2020 e ka nxjerr duke u bazuar në dispozitat e nenit 4 pikës 2.5, të ligjit Nr. 06/L-114,për Zyrtaret Publik, por ne kundërshtim me nenin 52 pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Në bazë të këtij vendimi Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka specifikuar saktë kohën se sa do të zgjasë transferimi i përkohshëm i ankueses siç parashihet me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton: **“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve dhe 1.2 për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve”**, sepse në bazë të legjislacionit duhet të përcaktohet kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me Nr. 141/2019 i datës 01.09.2020 i Zv. të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk përmban as elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.

05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj kjo ka shkaktuar edhe pasiguri juridike tek ankuesja sepse i njëjti vendim nuk ka asnjë arsyetim dhe është në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton: **“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu konstaton se Vendimi me Nr.141/2019 i datës 01.09.2020 i Zv. të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë i cili përcakton se: **“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit”**, po ashtu paragrafi 4 i nenit 4 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë përcakton se : **“Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit.”** kështu që duke marr parasysh dispozitat ligjore të lartcekura Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është i obliguar të rishqyrtoj rastin e sistemit të ankueses dhe të njëjtin ta bëjë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.297/2020

Hysni Mustafa

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses, [REDACTED]
- Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMShCK-së.